

VENDIM
Nr. 880, datë 11.11.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE TË NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË BASHKITË DURRËS, LEZHË DHE
KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 318 330 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe t’u kalojë bashkive Durrës, Lezhë dhe Kamzë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, përkatësisht, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 63 250 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 78 750 000 (shtatëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;

c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi prej 176 330 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekësh.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe